



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:060841
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05263695

C. nr. 723/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike të paditëses V/.N nga Komuna Gllogoc, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj Rr.H, nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shujtës ditore, vlera e kontestit 990.00 €, jashtë seance, me datën 26.01.2024 e mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET SE ËSHTË TERHEQUR** padia e paditëses V.N nga Komuna Gllogoc, paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave ditore për periudhën kohore nga dt.17.04.2017 e deri me dt.18.04.2020, vlera e kontestit 990.00 €.
- II. OBLIGOHET** paditësja V.N nga Komuna Gllogoc, që në afatin prej 7 ditë të bëj pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 Euro në llogarinë bankare të KGJK-së, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja V.N nga Komuna Gllogoc, përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim në Gllogoc, lidhur me kompensimin e shujtës, vlera e kontestit 990.00 €.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 22.12.2023, e ka tërhequr padinë C.nr.723/20 e dt. 29.05.2020 kundër të paditurës lidhur me shpenzimet e shujtës ditore për periudhën kohore nga dt.17.04.2017 e deri me dt.18.04.2020 duke theksuar se paditësja kërkesën për kompensimin e shujtave ditore e ka realizuar në procedurën administrative përmes Inspektoratit të Punës në Prishtinë.

Gjykata duke u bazuar në Nenin 387. par.1. pika c, lidhur me Nenin 261 par.1,3,4 dhe 5 të LPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka konstatuar se paditësja e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës në këtë çështje juridike lidhur me kërkesën kryesore dhe ka vendosë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Ndërsa për pikën II të këtij aktvendimi, gjykata ka vendosur në pajtim me Nenin 473 par. 1 dhe par. 3 të LPK-së lidhur me tarifën nr. 12 pika 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Neni 261 par. 4 i LPK-së përcakton se “ *Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi*”. Ndërsa të drejtën e ankesës kundër pikës II të dispozitivit të këtij aktvendimi e përcakton Neni 477 i LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, C. nr. 723/2020, me datë 26.01.2024**

**Gjyqtari
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër pikës I të këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, ndërsa kundër pikës II të aktvendimit lejohet ankesa në afat prej 7 ditë pas pranimit të të njëjtit për Gjykatën e Apelit e nëpërmjet kësaj gjykate.